



	AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Broj prot. Prot. No.	03-02-276/12
Data Datum Date	08.02.2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-02-4690/16, për z. Liridon Latifi – Anëtar Bordi në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4690/16, për z. Liridon Latifi – Anëtar Bordi në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Latifi, është hetuar për konflikt të mundshëm interesи sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.T.P. “Shopping Family”.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit me të cilën fillimisht ka njoftu zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, z. Latifi është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Latifi është bindur për kufizimin e ushtrimit të funksionit menaxherial në biznesin e tij privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t'u larguar nga ky funksion.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se në biznesin e tij privat ka caktuar një “person të besueshëm”, në cilësinë e personit të autorizuar, ndërsa vet ka mbetur si pronar pasiv. Me këtë ai kashmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

